

- 
- 
- 
- 
- 
- 
- 

KOHA

- [BALLINA](#)
- [LAJME](#)
- [KRONIKË](#)
- [KULTURË](#)
- [MESPËRMES](#)
- [VËSHTRIME](#)
- [SPORT](#)
- [LËMSH](#)
- [KONTAKT](#)
- [TJERA](#)



Bajrami vizitoi kompanitë kosovare, pjesë e panairit të madh ANUGA në Gjermani

10 Tetor 2015 - 20:45

Ministrja e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami vizitoi prezantimin e produkteve të kompanive kosovare në panairin e ushqimit dhe pijeve ANUGA i cili po mbahet nga data 10-14 tetor, 2015 në Këln të Gjermanisë, panair ky më i madhi i këtij sektori në Evropë.

Kjo pjesëmarrje e kompanive vjen si rezultat i bashkëpunimit të kompanive prodhuese kosovare me MTI-në, Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA), donatorët: USAID, Swisscontact, UNDP si dhe Shoqatës Kosovare të Përpunuesve Pemë dhe Perime.

Panairi ka karakter ndërkombëtar dhe marrin pjesë mbi 90 vende nga tërë bota me një pjesëmarrje prej mbi 6.700 pjesëmarrës (ekspozues). Prodhuesit kosovarë pjesëmarrës në këtë panair do të kenë mundësinë të ekspozojnë produktet e tyre dhe të krijojnë lidhje biznesi e marrëdhënie kontraktuale me partnerë nga e mbarë bota.

Gjithashtu ministrja Bajrami, e shoqëruar nga konsulli i Kosovës në Frankfurt, i bëri një vizitë edhe Unionit të Bizneseve Shqiptare në Gjermani, union ky i themeluar para dy viteve, me rreth 200 anëtarë.

Kryetari i Unionit, Nazmi Viça, tregoi se qëllimi i kësaj shoqate është bashkimi i bizneseve shqiptare në Gjermani si dhe fuqizimi i tyre. Ai bëri të ditur se anëtarësimi rreth këtij Unioni po rritet gjithnjë e më shumë dhe ndihma që japin për vendin e tyre të lindjes vazhdon në mënyra të ndryshme.

Ministrja Bajrami tha se në Kosovë po ndryshon ambienti i biznesit.

“Kemi rifunksionalizuar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës (KKZHE) i cili paraqet një platformë të rëndësishme për dialogun publiko-privat dhe për adresimin e barrierave dhe sfidave të bizneseve. Po merremi shumë seriozisht me të gjitha barrierat dhe kërkesat e bizneseve, të cilat pastaj po i adresojmë tek mekanizmat përkatës në kuadër të këtij Këshilli”, potencoi ministrja Bajrami.

Një nga lehtësirat që po i krijon qeveria për biznese, sipas Bajramit, është edhe implementimi i pakos së re fiskale, e cila ka hyrë në fuqi që nga 1 shtatori i këtij viti dhe se tashmë bizneset kanë filluar t’i ndiejnë efektet e saj. Ajo njëkohësisht bëri të ditur se është në finalizim udhëzimi administrativ për pushime tatimore, ku bizneset e caktuara do të lirohen nga tatimi në fitim gjatë investimeve.

Ajo, gjithashtu ceku se tashmë e kemi hartuar një draft-ligj për investime strategjike, i cili do të përcaktojë fushat e zhvillimit strategjik të Kosovës, që do të thjeshtëzojë procedurat për

investime dhe njëkohësisht do të mundësojë negocimin e drejtpërdrejtë me investitorë strategjikë për të sjellë investime të reja në Kosovë.

“Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia për Promovim të Investimeve do të jenë gjithmonë një derë e hapur dhe do të vazhdojnë të luajnë rolin avokues për të gjitha bizneset”, premtoi ministrja.

Përfaqësues të bizneseve kërkuan nga institucionet e vendit infrastrukturë ligjore që ua bën më të lehtë zhvillimin e procedurave për investime dhe që ofron mbrojtjen e investimeve.

Kompanitë kosovare pjesëmarrëse në panair janë Bodrumi i vjetër - Rahovec, Liri, Sole Kosova, Hit flores, Fungo FF, Golden Eagle, Frutomania, Abi Elif, Baha, Eko Wine, Winery Rahovec.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Të fundit



[Vendos Kryesia: Nesër kontroll i rreptë për zyrtarët që hyjnë në Kuvend \[dokument\]](#)



[Fullanit i takojnë miliona lekë dëmshpërblim për burgun](#)



[Fëmijët që kërkojnë lëmoshë, pre e grupeve kriminale](#)



[Me 500 euro në Universitetin e Shkodrës blen dy nota](#)



[Nekrologë për vdekjen e Demokracisë shpërndahen nëpër Prishtinë](#)



[KMDLNJ: Gaxherri të kërkojë falje publike për ish të burgosurit politikë](#)

Rrjetet sociale





Të tjera

[**Ylli Hoxha dhe 8 protestuesit tjerë dalin para Gjykatës**](#)

14 Tetor 2015 - 13:06

[**Rikthehen në Kuvend të Prishtinës plani rregulluese të bllokuara 6 muaj**](#)

14 Tetor 2015 - 13:03

[**Rushdie: Shkrimtarët e sfidojnë frikën, letërsia është guxim**](#)

14 Tetor 2015 - 13:00

[**Kapen në Vlorë mbi 200 kg drogë dhe armë, 8 në pranga**](#)

14 Tetor 2015 - 12:54

[**Vendos Kryesia: Nesër kontroll i rreptë për zyrtarët që hyjnë në Kuvend \[dokument\]**](#)

14 Tetor 2015 - 12:50

Karikatura e ditës



[Jeton Mikullovc](#)
[Galeria >](#)

KOHA

- [Lajme](#)
- [Kronikë](#)
- [Kulturë](#)
- [Mespërmes](#)
- [Vështrimë](#)
- [Sport](#)
- [Lëmsh](#)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Portali Koha.net / Zhvilluar nga [Frakton](#)

038 249 105 info@koha.net Sheshi Nënë Tereza pn, Prishtinë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. **Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.**

Ec me kohën...